



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS/ SUDSKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KOMISIONI DISIPLINOR, në përbërje nga zt. Muharrem Shala, kryetar, zt. Gerrit Sprenger dhe zt. Biljgaip Maznikar, anëtarë, duke e shqyrtuar qështjen e përgjegjësisë disiplinore ndaj zt. Xxxxx xxxx, gjyqtar në Gjykatën Komunale në xxxxx, i cili ngarkohet sipas raportit përfundimtar të Zyrës së Prokurorit Disiplinor (ZPD), me nr. ZPD -2009-053 për sjellje të pahijshme të përcaktuar sipas nenit 5.3 (b) dhe (d) të Urdhëresës Administrative nr. 2006/8 si dhe për shkelje të Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për gjyqtar, (në pjesën nën I- Parimet e përgjithshme, pika dy dhe në pjesën nën III, 1 (A) Rregullat Specifike të Sjelljes Profesionale, në seancën dëgjimore të mbajtur në prezencën e përfaqësuesve të ZPD-së, znj. Mejreme Halili dhe gjyqtarit xxxx xxxxx, me datë 14/10/2011, në bazë të nenit 36. par. 1 .të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës merr këtë:

V E N D I M

I. xxxx xxxxx, gjyqtar në Gjykatën Komunale në Gjakovë, është përgjegjës për sjellje të pahijshme të përcaktuar sipas nenit 5.3 (b) dhe (d) të Urdhëresës Administrative nr. 2006/8 si dhe për shkelje të Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për gjyqtar, (në pjesën nën I- Parimet e përgjithshme, pika dy dhe në pjesën nën III, 1 (A) Rregullat Specifike të Sjelljes Profesionale.

II. Sa i përket sanksionit disiplinor, për sjellje të pahijshme, gjyqtarit xxxxx xxxxx, i shqiptohet masa disiplinore **QORTIM**.

A r s y e t i m

Zyra e Prokurorit Disiplinor me datë 21/04/2011 ia ka paraqitur raportin përfundimtar Komisionit Disiplinor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me të cilin e ngarkon zt. Xxxxx xxxxx, për sjellje të pahijshme të përcaktuar sipas nenit 5.3 (b) dhe (d) të Urdhëresës Administrative nr. 2006/8 si dhe për shkelje të Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për gjyqtar, (në pjesën nën I- Parimet e përgjithshme, pika dy dhe në pjesën nën III, 1 (A) Rregullat Specifike të Sjelljes Profesionale.

Në seancën dëgjimore të Komisionit Disiplinor të mbajtur më datën 14/10/2011, përfaqësuesja e ZPD e ka mbështetur në tërësi raportin përfundimtar, duke përfunduar me gjetjen e sjelljes së pahijshme që konsiston në mënyrën, e cila është e pa pajtueshme me detyrën e një gjyqtari të përcaktuar me ligj.

ZPD-ja, ka hapur hetim dhe ka ardhur në përfundim se gjyqtari xxxxx e ka zvarritur procedimin e lëndës P. nr 252/04 me mos ndërmarrjen e ndonjë veprimi procedural për dy vite e gjashtë muaj, pas pranimit të aktakuzës së precizuar, me ëka gjyqtari ka lejuar parashkrimin e lëndës penale.

Duke konsideruar se veprimi i tillë në opinion dëmton imazhin e tij si gjyqtar të gjykatës dhe gjyqësorit në përgjithësi, përfaqësuesja e ZPD-së e mbështet në tërësi raportin dhe i propozon Komisionit Disiplinor shqiptimin e masës disiplinore qortim.

Gjyqtari xxxx xxxxx e kundërshton në tërësi raportin përfundimtar të ZPD-së duke deklaruar se ndjekja dhe zhvillimi i procedures disiplinore është parashkruar duke e njoftuar komisionin për përvojën e tij 34- vjeçare në gjyqësi si dhe ngarkesën e madhe me lëndë me më shumë se 1.370 lëndë, të cilat i ka pasur në punë.

Për rastin në fjalë, gjyqtari xxxx thotë: “kemi të bëjmë me 8 të akuzuar për 19 vepra penale të vjedhjes. Prokurori e ka ngritur aktakuzën për të gjithë të akuzuarit për të gjitha veprat. Prej 8 të akuzuarve 4 prej tyre kanë qenë jashtë Republikës së Kosovës. Më pastaj, prokuroria e ka bërë veçimin e procedurës penale për arsye të efikasitetit mirëpo, veçimi nuk është bërë edhe për 19 vepra penale. Po të ishte një vepër penale ndaj dy ose tre të akuzuarve nuk kishte me pasur zvarritje. Edhe pse, unë konsideroj se në këtë lëndë nuk ka pasur zvarritje”.

Komisioni Disiplinor i administroi të gjitha provat në shkresat e lëndës si dhe të gjitha provat e paraqitura gjatë seancës dëgjimore. Duke i vlerësuar provat materiale që gjenden në lëndë si dhe vetë mbrojtjen e gjyqtarit xxxx, Komisioni konstaton se vertet gjyqtari ka qenë i ngarkuar me lëndë, që shihet edhe nga regjistri i ndarjes së lëndëve, por në rastin

konkret ekziston doza e fajësisë së gjyqtarit xxxxx, sepse ka lejuar që më shumë se dy vite e gjysmë të zvarritet lënda deri në parashkrimin e ndjekjes penale.

Prandaj, bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar në këtë mënyrë, komisioni vlerëson se, gjyqtari xxxxx xxxx është përgjegjës për sjellje të pahijshme të përcaktuar sipas nenit 5.3 (b) dhe (d) të Urdhërësës Administrative nr. 2006/8 si dhe për shkelje të Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për gjyqtar, (në pjesën nën I- Parimet e përgjithshme, pika dy dhe në pjesën nën III, 1 (A) Rregullat Specifike të Sjelljes Profesionale.

Lidhur me masën disiplinore komisioni disiplinor, vlerësoi se masa e Qortimit është proporcionale me sjelljen e pahijshme të vërtetuar dhe vlerëson se një masë e tillë do ta arrijë efektin që gjyqtari xxxxxx në të ardhmen të mos përsërisë sjellje të tilla.

Komisioni e ka vlerësuar kundërshtimin e parashkrimit të procedurës disiplinore të theksuar nga ana e zt. Xxxxx xxxxx, mirëpo gjer me tani me asnjë dispozitë të rregulloreve të lartëpërmendura të cilat ishin në fuqi nuk është rregulluar parashkrimi i procedurës disiplinore dhe parashkrimi si institut nuk është rregulluar edhe në bazë të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe për këto arsye nuk është aprovuar kundërshtimi i parashkrimit.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij vendimi në bazë të nenit 37. pika 1.1 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

KOMISIONI DISIPLINOR
KD- 34 /2011, datë 14/ 10/ 2011

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur
ka të drejtë ankese pranë Këshillit
Gjyqësor të Kosovës në Prishtinë, brenda
afatit prej 15- ditësh, nga dita e pranimi të vendimit.

Të bashkëngjitur gjeni Formularin A.



Vendimi u dërgohet;

- zt. Enver Peci, kryesues i KGJK-ës;
- zt. Albert Avdiu , drejtor i SKGJK-ës;
- zt. Kadri Begolli, shef, Zyra e Prokurorit Disiplinor;
- zt. XXXXX XXXXX, gjyqtar në gjykatën Komunale në XXXXXXX;
- znj. XXXXX XXXXX, kryetare i Gjykatës Komunale në XXXXXXX;